



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

**Komuna e Prizrenit**  
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale-Prizren Direktorijat za Rad i Socialno Staranje-Iş Ve Sosyal Esirgeme Müdürlüğü

### **THIRRJE PËR APLIKIM**

Komuna e Prizrenit, përkatësisht Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke u bazuar në rregulloren MF -Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, rregulloren Komunale nr. 001/011 - 201 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes se Subvencioneve dhe Transfereve dhe Granteve. Fton të gjitha OJQ-të dhe individët në fushën e shërbimeve sociale, që të aplikojnë për financim për implementim të projekteve të tyre.

Projektet duhet të jenë në përputhje me politikat dhe programore e fushave sociale, të cilat janë:

- Shërbime alternative për mbrojtje të fëmijëve të braktisur regrutimi i familjeve strehuese për ofrimin e shërbimeve për fëmijët ne strehim familjar (te gjitha komuniteteve)
- Shërbime të rehabilitimit ,këshillim psikosocial dhe trajtimit te avancuar për personat me nevoja të veçanta fëmijë dhe të rritur (të verbëritë, të shurdhër, tetraplegjike, paraplegjike, lehtësimi i qasjes ne marrjen e te gjitha shërbimeve te nevojshme )
- Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale , rezidenciale, ditore përmes aktiviteteve rekreative për pensionist dhe persona të moshuar pa kujdes familjare .
- Shërbime mbështetëse dhe këshilluese për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara mendore si dhe trajnimi i stafit per këto kategori ne avancimin e dhënies se shërbimeve .
- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe grave, viktimave të dhunës në familje ,abuzimeve te ndryshme ,trafikimi me qenie njerëzore; si dhe mbështetja e grave për pavarësimin e tyre (nënat vetushqyese).
- Fëmijët dhe të rinjtë, të cilët janë apo munde te jene viktimat të bullizmit
- Aftësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara për treg të punës.
- Minoritetet etnike në përfshirje sociale; -
- Përdoruesit e substancave psiko-aktive;
- Familjet në kushte të pafavorshme socio-ekonomike.

#### **Kriteret:**

1. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë implementuar projekte në të cilat kanë qenë të përfshira grupet sociale (personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të marginalizuara)
2. Projekt propozimi duhet të jetë unik, d.m.th. nuk është implementuar në aktivitetet e mëparshme të këtij lloji
3. Në kushte të barabarta, përparësi do të kenë projektet të cilat kanë për synim involvimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar
4. Përparësi në përzgjedhje do të kenë projektet që bazohen në politikat komunale për mirëqenie të qytetarëve në nevojë. Në këtë thirrje mund të aplikojnë edhe një grup organizatash së bashku për implementimin e një projekti të caktuar, të natyrës së njëjtë.

## **Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes**

Aktivitetet ne ofrimin e shërbimeve sociale, OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën mbrojtjes së grupeve të kësaj thirrjeje dhe me target grupet:

- Mbrojtja e fëmijëve te braktisur pa kujdes familjare avancimi i strehim it familjar ne komunën e Prizrenit .
- Personat me nevoja te veçanta
- Fëmijët në situata të rënda sociale/pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik për humbjen e përkujdesit prindëror, viktima të dhunës në familje, trafikim me qenie njerëzore, keqtrajtimit, situatë rruge, bullizimit, braktisja e shkolles etj.
- Të rriturit në situata të rënda sociale/ viktima të dhunës në familje, trafikim me qenie njerëzore,
- Të moshuarit;
- Minoritetet etnike;
- Përdoruesit e substancave narkotike;
- Fuqizimi i kërkesave tek të rinjtë për tregun e punës.

### **Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Kopja e letërnjoftimit për parashtruesin e kërkesës;
  - Certifikata e numrit të regjistrimit të OJQ-së;
  - Certifikata e numrit fiskal të OJQ-së;
  - Letërnjoftimi i bartësit të xhirologarisë;
  - Vërtetimi/ dëshmia e bankës së subjektit i cili aplikon;
  - Për organizatat që aplikojnë me projektet për ofrimin e shërbimeve sociale dhe psikologjike profesionale, duhet të dorëzojnë certifikatën e licencimit të OJQ-së nga Ministria gjegjëse
  - OJQ-të aplikuese të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike.
  - OJQ të jetë e pajisur me Numër Fiskal, të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.
  - OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së.
  - OJQ-ja nuk është në procedurë të shuarjes dhe çregjistrimit.
  - OJQ-ja të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete tek shërbimet sociale nga MFPT.
- ✓ Për individët që aplikojnë me projektet për ofrimin e shërbimeve sociale apo psikologjike, profesionisti duhet të dorëzojë certifikatën e licencimit nga Ministria gjegjëse.
  - ✓ Te gjitha organizatat e interesuara per aplikim duhet ti paraqesin te gjitha dëshmitë per plotësimin e kriterëve te përgjithshme dhe specifike sipas nenit 10 dhe 11 te Rregullores MF-NR.04/2017 per kriteret ,standardet dhe Procedurat e financimit publik

Shënim: Organizatat që aplikojnë me projektet për familjet e cënueshme me gjendje të rënde ekonomike-sociale, dhe që kanë nevojë për ndërhyrje emergjente nuk kërkohet certifikata e licencimit nga MD.

Të dhënat e aplikuesit: numri i telefonit, e-maili, adresa.

## Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i thirrjes është 15 ditë pune nga data e hapjes së thirrjes nga dt 11.03.2024 deri me 29.03.2024 deri në orën 16.00 . Aplikacioni i dorëzuar brenda periudhës së thirrjes gjithashtu pranohet nëse vula pranuese tregon se është dorëzuar në postë deri në fund të datës së thirrjes, si afati i fundit për dorëzimin. Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh

Projekt propozimet mund të dorëzohen në të gjitha sportelet e Administratës Komunale.

  
DPMS  
  
Rasim Demiri, drejtori i DPMS-se